



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni Pranvror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 04/2010

Prishtinë më 02. 02. 2010, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

**I mbledhjës së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport
dhe Telekomunikacion**

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Nerxhivane Dauti, Fatmir Rexhepi, Kaqusha Jashari, Sala Berisha - Shala dhe Zef Morina.

Munguan: Slobodan Petroviq, Qamile Morina dhe Myfera Sinik.

Emrat e të ftuarve dhe të pjesëmarrësve të tjerë: Visar Ramaj – KDI, Haxhi Gashi - USAID, Besim Zeqiri - ICO, Shqipe Arifaj - Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe Ibrahim Krasniqi - konsulent i Komisionit.

Emrat e Stafit Mbështetës të Komisionit: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

- 1 Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 19. 01. 2010 dhe 25. 01. 2010,
3. Raportimi i ministrit të MTPT- së për situatën aktuale lidhur me Projektin e autoudhës “Morinë - Merdare”,

4. Miratimi i Raportit final me amendamente të P/ligjit për turizëm dhe shërbime turistike;
5. Te ndryshme;

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

I. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

II. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve më 19.01. 2010 dhe 25. 01. 2010

Kryetarja e Komisionit konstatoi se miratohen procesverbalet e mbledhjeve më 19. 01. 2010 dhe 25. 01. 2010 pa vërejtje.

III. Raportimi i ministrit të MTPT- së për situatën aktuale lidhur me Projektin e autoudhës ‘Morinë-Merdare’

Kryetarja – I njoftoi anëtarët e Komisionit së ka ardhur një njoftim nga Ministria e Transportit dhe Post -Telekomunikacionit (në vijim MTPT- së), ministri Limaj për shkak të agjendës së ngjeshur nuk mund të marrë pjesë në mbledhje të Komisionit para datës 16. 02. 2010.

Fatmir Rexhepi – Theksoi se ministri Limaj, është dashur gjithsesi të jetë, pavarësisht agjendës së tij, sepse kjo është një çështje e një rëndësie të lartë. Ai shtoi se duhej ta gjente mundësinë edhe nga Grupi i tij parlamentar ta ftojë ministrin në interpelancë për këtë çështje, sepse është arsye e madhe autostrada ‘Morinë – Merdare’ dhe se ministri po i ik debatit dhe ftesës së Komisionit. Po ashtu theksoi se po përgatitët një skenar i njëjtë dhe është rrezik të krijohet gjendja dhe modeli i Shqipërisë. Gabim i madh ka qenë përzgjedhja e kompanisë së njëjtë, Bechtel Enka, që ta ndërtojë autostradën. Në fund tha se ky veprim i ministrit është antikushtetues dhe po veprohet më një jotransparencë të pashembullt.

Kaqusha Jashari – Theksoi se ka pritur shumë nga ky takim me vetë pjesëmarrjen e ministrit. Mirëpo kërkoi që Kuvendi të këtë kujdes për këtë projekt shumë të rëndësishëm për vendin. Nëse do të bëhen ndryshime, duhet të respektohet procedura dhe rrjeti i Korridorit Ballkanik, sepse më këto modifikime është duke shkuar në këtë drejtim. Kërkoi të mos ngutemi në këtë drejtim, sepse do të jetë më mirë, duke e cilësuar Korridorin Ballkanik si Strategji politike sesa vetë rruga.

Zef Morina – Theksoi se mund të arsyetohet mospjesëmarrja e ministrit për shkak të agjendës, mirëpo në këtë rast është dashur ta zëvendësojë zëvendësministri ose së paku do duhej të sillej material, në mënyrë që ta kemi një pasqyrë më të qartë për këtë çështje. Ai shtoi se duhet të kemi kujdes, sepse Kosova më 11 qershor 2004 ka nënshkruar marrëveshjen REBIS në Luksemburg, ku Kosova bëhet pjesë e zhvillimeve panevropiane, dhe kjo trase është paraparë të jetë pjesë e këtij zhvillimi. Në fund tha se nuk është i pajtimit që të ftohet ministri në interpelancë, sepse debati në seancë pastaj po

merr kahe të politikës dhe fushatave të ndryshme.

Ethem Çeku – Tha se për dy çështje do të duhej të diskutohej me këtë rast, e para; kuptohet së ministri ka agjendë dhe detyrime të tjera, mirëpo është dashur të jetë zëvendësministri këtu, në takim, ose së paku të silllej material shtesë; ndërsa e dyta; për çështje të mëdha të vendit duhet të kemi edhe konsensus politik dhe të mos merren vendimet në mënyrë të njëanshme.

Sala Berisha – Shala – Theksoi se në mbledhjen e kaluar jemi pajtuar si Komision që ministri të jetë në Komision, për ta trajtuar këtë çështje, dhe për këtë i kemi dërguar ftesë zyrtare. Mirëpo, ministri ka lajmuar më kohë se për shkak të agjendës nuk mund të jetë prezent, prandaj nuk duhet të merret si ikje nga përgjegjësia. Ajo propozoi; ekziston edhe një mundësi që të shkojë Komisioni në MTPT dhe t'i shikojë shkresat dhe Projektin në tërësi, nëse është nevoja. Prandaj nuk është e drejtë që në këtë mbledhje të Komisionit, të shfrytëzohet media dhe të kritikohet ministri për të përfituar dikush kredibilitet politik. Në fund tha se nuk e përkrah idenë që të shkohet në interpelancë, por ai deputet që e sheh të arsyeshme lë t'i shfrytëzojë rregullat dhe procedurat përmes Grupit të tij parlamentar.

Kryetarja – Theksoi se ministri Limaj është dashur ta respektojë detyrimin ligjor që ka për të raportuar në Komision për çështje që ngritën për diskutim ose së paku është dashur të sillte material përkatës për trasenë e Autostradës. Duke shtuar më tej se në Komision dhe pastaj në seancë është miratuar kjo trase dhe për këtë arsye Kuvendi është institucioni i cili mund të bëjë ndryshimin e trasesë. Dhe propozoi që të ftohet në një interpelancë ministri Limaj dhe të debatohet për këtë çështje, sepse bëhet vonë, është festa e pavarësisë më 17 shkurt dhe nuk kemi kohë për të humbur.

Fatmir Rexhepi – Theksoi se në fillim kemi kërkuar debat në Komision. Ministri nuk është lajmëruar dhe e ka injoruar Komisionin. Tashti ka mbetur vetëm një alternativë që të shkohet në interpelancë. Ai shtoi se Kosova po e merr modelin e Shqipërisë, i cili është model korruptues dhe më këtë ndryshim të propozuar nga ministria po anashkalohet një pjesë e mirë e vendit dhe po favorizohen rajone të posaçme. Kjo nuk duhet lejuar.

Kaqusha Jashari – Tha se nuk mund të ndryshohet për shkak së është korridor Trans Ballkanik dhe bëri thirrje për një debat konstruktiv për shkak së kjo është një çështje kapitale për shtetin tonë. Ajo, për këtë çështje, kërkoi të këtë konsensus në Kuvend.

Zef Morina – Theksoi se kjo trase ishte ide e ish - presidentit Ibrahim Rugova dhe është e standardit evropian të ndërtohet me dy korsi. Nëse kjo ndryshohet e humb kuptimin e autostradës, sepse edhe Shqipëria e ka pasur Projektin më dy korsi, por kemi bërë presion si Kosovë, në atë kohë, kur ka qenë kryeministër Pandeli Majko. Tani ajo është ndërtuar më katër korsi. Në fund theksoj se nuk pajtohet që Projekti të ndahet në këtë formë çfarë po pretendohet tani.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

- I. Të ftohet përsëri më 05. 02. 2010 në takim të Komisionit, ministri i Transportit dhe Post -Telekomunikacionit, z. Limaj ose zëvendësministri i Ministrisë.
- II. Të sillet material shtesë nga Ministria për trasenë e autostradës “Morinë – Merdare”.

IV. Miratimi i Raportit final me amendamente të Projektligjit për turizëm dhe shërbime turistike

Kryetarja – Kërkoj të miratohet Raportit final me amendamente i Projektligjit për turizëm dhe shërbime turistike dhe të procedohet për miratim në seancë plenare pasi që janë pjekur kushtet ligjore.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

- I. Miratohet Raporti me Rekomandime për Projektligjin për turizmin dhe shërbimet turistike.
- II. Raporti të procedohet për miratim në seancë plenare.

V. Të ndryshme

a) **Kryetarja** – I njoftoi se në Strategjinë legjislative për vitin 2010, duhet të parashihet që të shqyrtohen dhe të miratohen 25 (njëzet e pesë) Projektligje nga Komisioni për ETIETT dhe propozoi që të formohet një Grup punues për ta hartuar një plan pune

Pas debatit, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Deputetja Nerxhivane Dauti ta formojë një Grup punues që ta hartojë një plan- program për shqyrtimin e projektligjeve nga Komisioni që janë paraparë në Strategjinë legjislative.

b) **Kryetarja** – Propozoi që në mbledhjen e datës 09. 01. 2010, të jenë në shqyrtim Projektligji për miniera dhe minerale dhe Projektligji për shërbimet postare.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Rendi i ditës të mbledhjes së datës 09.01.2010 të jetë në shqyrtim Projektligji për shërbimet postare.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani

